

PKR.nr.192/14

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Musa Konxheli, Ilir Bytyqi dhe Hakile Ilazi anëtar të trupit gjykues si dhe bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit I.T., për shkak të veprave penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nën par.1.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 dhe veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.145/13 te datës 30.10.2014, në praninë e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Florije Salihu Shamolli, të pandehurit I.T., mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av.R.A., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.27.10.2016, morri dhe publikisht shpalli këtë :

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **I.T.**, nga rr.....- Ferizajt data e lindjes....., në fsh....., Komuna Kaçanik, nga i ati I., e ëma M. e gjinisë L., , ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar babë i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës

**Konform nenit 363 par.1, nenpar 1.1 te KPPRK-se, Me qe Prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza gjate shqyrtimit gjyqësor.**

**REFUZOHET AKUZA**

Ndaj te pandehurit I.T. sa i përket pikes se pare/ dispozitivit te pare/ të aktakuzës per veprën penale vrasje e rëndë në tentative nga neni 179 par.1 nën par 1.8 lidhur me nenin 28 te KPRK-së,

1. Sepse: me dt.23.08.2013, rreth ores 21,00 në rrugën Zahir Neziri në Ferizaj afër lokalit xhamprerës “.....”, me dashje ka tentuar të privoj nga jeta të dëmtuarin E.P. nga hakmarrja e paskrupulltë në atë mënyrë që me qëllim hakmarrje pasai që djali I vllaut të tij K.P.1 më pare kishte privuar djalin e të pandehurit V.T., kështu që I pandehuri ditën kritike gjersa I dëmtuari E.P. ishte duke biseduar me K.P.2 ne rr.Zahir Neziri I pandehuri nxjerr revolën e markës TT e kalibrit 7.62 mm dhe nga distance rreth 10 metra shkrep një fishek në drejtim të victims mirëpo nuk arrin të qëlloj falë ndihmës së dëshmitarit K.P.2 I cili kishte vërejtur të pandehurin duke e nxjerr revolen, dhe I bërtet victims me fjalët “ruaju” dhe njëkohësisht e tërheq për krahu të dëmtuarin dhe me dorë shtynë në anën e djathtë të murit ndërsa fisheku të dëmtuarit I kalon përreth belit por që nuk arrin ta qëlloj, kurse I pandehuri arratiset në drejtim të panjohur

**Me këtë do ta kryente veprën penale: vrasje e rëndë në tentativ nga neni 179 par.1 nën par.1.8 lidhur me nenin 28 të KPK-se**

**Ndërsa sa I përket dispozitivit të dytë dhe të tretë I pandehuri I.T.:**

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë të papërcaktuar e deri më 23.08.2013 në shtëpinë e tij në rrugën Rexhep Bislimi në Ferizaj ka mbajtur pa autorizim armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët pa leje për mbajtjen e armës- pistoletën e modifikuar me nr.EM7110322 e cila me rastin e kontrollit të shtëpisë i sekuestrohen nga ana e policisë përkohësisht,

**-me këtë ka kryer veprën mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.**

Me datë të pa përcaktuar e gjerë me datën 23.08.2013 ka mbajtur pa autorizim armën-revolen e tipit TT e kalibrit 7.62 mm në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm të armëve e të cilën armë e ka përdorur si në dispozitivin 1 të kësaj akuze

**-me këtë ka kryer veprën përdorim i armëve apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 3,6, 17,21,41,43,45,46, dhe 73 të KPK-së si dhe nenin , 363,365 dhe 359 të KPRK –së të pandehurin e :

### **G J Y K O N**

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së. gjykohet me **dënim me gjobë ne shumën prej 400 €**,

Për veprën penale përdorim i armëve apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së gjykohet me **dënim me burg prej 8/tetë/ muaj si dhe dënim me gjobë prej 800/tetë qind/ euro**

Konform nenit 80 të KPRK-së të akuzuarit I.T. , gjykata I shqipton **dënim unik prej prej 8/tetë/ muaj burgimi dhe dënim me gjobë prej 1200/ një mijë e dy qind / euro** ku të njejtit do ti llogaritet koha e kaluar ne paraburgim prej dt.08.10.2014 deri më .

**Dënimi me gjobe në shumë prej 1200 euro** nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjatë periudhës verifikuese në afat prej dy viti nga plotëfuqishmeria e këtij aktgjykimi nuk kryen veper penale tjetër të kësaj natyre.

Konform nenit 375 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma-pistoleta e modifikuar me nr.EM7110322.

Konform nenit 453 par.4 te KPPRK-se, I pandehuri I.T., lirohet nga detyrimi i kompenzimit ne tersi te shpenzimeve te procedurës penale, meqense I pandehuri ka dorëzuar ne gjykatë vërtetimin se familja e tij është shfrytëzuese e ndihmave sociale (kjo vëtetohet nga Kartoni I ndihmës sociale me nr.te regjistrit ..... të dt.09.03.2016.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.145/13 të datës 30.10.2014 ka ngarkuar të pandehurin I.T., për veprat penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nën par.1.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 dhe veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.08.2016, ku ne seancën e dt.27.10.2016 përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Florije Salihu Shamolli u tërhoq nga akuza sa I përket dispozitivit të pare me te cilën I pandehuri ngarkohet me veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nën par.1.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së , kurse sa I përket dispozitivit të dytë dhe të trete prokurori I shtetit mbeti në tërsi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri I.T. në shqyrtimin gjyqësor me dt. 27.10.2016 ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 dhe veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së dhe premtion se nuk dot ë kryej vepra të tilla apo të ngjashme.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë,
- pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, përmbajtja e dosjes së forenzikës të dt.23.08.2013, ekspertiza për ekspertim të armëve të zjarrit të dt.15.11.2013, shikimi i procesverbalit mbi kontrollimin e banesave lokaleve dhe personave të dt.23.10.2013, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm te sendeve i dt. 23.10.2013 si dhe shikimi i fotografive që gjinden në shkresat e lëndës.

- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen tiparet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 dhe veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së

Konform nenit 375 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma- pistoleta e modifikuar me nr.EM7110322.

Konform nenit 453 par.4 të KPRK-se, I pandehuri I.T., lirohet nga detyrimi i kompenzimit në tersi të shpenzimeve të procedurës penale, meqenëse I pandehuri ka dorëzuar në gjykatë vërtetimin se familja e tij është shfrytëzuese e ndihmave sociale (kjo vërtetohet nga Kartoni I ndihmës sociale me nr.te regjistrimit ..... të dt.09.03.2016.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RENDA,  
PKR.nr.192/14 e dt.27.10.2016**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

**Kryetari i trupit gjykues,**

Musa Konxheli

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.